

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuara Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Përpara se të merrja disa argumente, që lidhen me këtë projektbuxhet, i cili, në respekt të qytetarëve, duhet diskutuar jo vetëm politikisht, por edhe teknikisht, sa është e mundur, dua të jap opinionin tim lidhur me një ftesë të vazhdueshme që u bë nga maxhoranca për ta votuar së bashku këtë projektbuxhet dhe për të dhënë një shembull të mirë në këtë drejtim. Duke u përpjekur ta ndajmë dhe ta pastrojmë ambientin nga kjo lloj hipokrizie e panevojshme, është e qartë që kjo maxhorancë kur ka qenë në opozitë nuk ka dhënë kurrë një shembull të tillë, edhe kur ka bërë shumë për çështje të mëdha parimore, për të cilat kishte kohë që kur të vinte në pushtet të demonstronte se ato që thoshte nuk ishin thjesht dhe vetëm hipokrizi e mashtrim. Meqenëse jemi në kohë të vështira dhe Shqipëria është në një moment të vështirë, po ju kujtoj një shembull kur kjo maxhorancë ishte në opozitë, po në këtë sallë, kur diskutohej projektbuxheti (për ata që kanë memorie vetëm që nga viti 2013 e më pas, duhet t'u them që ka pasur politikë edhe para vitit 2013), bërtiti shumë për të hequr TVSH-në e artikujve të shportës, TVSH-në për 20%-in, i cili u shndërrua në kalë beteje të fushatës dhe u ulurit, u brohorit dhe u çor nga Edi Rama me të gjitha mënyrat e veta. Ndërsa sot, që po diskutojmë buxhetin e nëntë të kësaj maxhorance, le të më thotë një nga anëtarët e kësaj maxhorance, a e mbajtën këtë premtim për të cilin ulëritën dhe kryqëzuan dikur të tjerët, që ishin në maxhorancë? Nëse dikush më thotë se ky premtim është mbajtur, unë e votoj projektbuxhetin, por që të na bëni ortakë të këtij mashtrimi hipokrit dhe standardin e hipokrizisë të na e impononi si standardin më të mirë sepse ju duhet juve, kjo është për ta kthyer mbrapsht dhe refuzuar njëherë e mirë.

Mora vetëm një shembull sinjifikativ, sepse bëhet fjalë për një Shqipëri që vuan dhe për një Shqipëri në ditë të vështira në planin ekonomik, ku ekonomia familjare, që është fundi i interesit të kësaj maxhorance, nuk është prioritet dhe për këtë arsye them ta refuzojmë, sepse projektbuxheti, në mënyrë normale, duhet të kishte dy themele: Së pari, sesi mund të mbështeteshin me çdo masë, me çdo mjet proteksionist dhe me çdo lloj konsultimi pa fund bizneset shqiptare. Kjo duhet të ndodhte, sepse vinim pas goditjeve ekonomike shumë të rënda të pandemisë, të cilat ishin shumë të rënda dhe shumë të fuqishme edhe për vendet e mëdha. Mendoni mundësitë që ka biznesi shqiptar dhe sa nevojë do të kishte për një qëndrim tjetër, por ju e kuptoni që ishte periferik dhe nuk ekzistonte fare. Së dyti, çështje tjetër madhore ishte si të përballohet problematika shëndetësore, me të cilën vazhdojmë të bashkëjetojmë; si jemi ndarë nga pandemia dhe kush do të flasë teknikisht, sepse këtu nuk flitet teknikisht. Vazhdojmë të kemi një ritëm rastesh, te 500 e ca raste, që në raport me numrin e testeve është 20-25%, domethënë, shumë e lartë, që do të thotë se vazhdojmë të jemi në pandemi të plotë. Këtë e thotë shkenca, që po të doni, me urdhër të qeverisë, i shkelim edhe librat e shkencës, por shkenca këtë na thotë.

Pra, këto duhet të ishin këmbët ku do të mbështetej buxheti, por që të dyja këto këmbë janë të thyera. Të gjitha shoqatat e prodhuesve shqiptarë pohojnë shqip që me një buxhet të tillë mbi 85- 90% e buxheteve do të vuajnë shumë dhe do të jenë sërish në riskun e mbijetesë. Po ashtu, prodhimi shqiptar apo eksportet shqiptare do të jenë më të rrezikuara se kurrë. E njëjta gjë do të ndodhë. Ne dëgjojmë

ditirambe këtu edhe për programin për bujqësinë, por nuk është e nevojshme të bëj komente apo oponentë, sepse përgjigjen e kishit në shesh. Nëse fermerët do të ishin të kënaqur dhe të lumtur, ata nuk do të kishin arsye pse të dilnin, por nëse u rrit inputet me 10%, u heq TVSH-në 6%, u shton me 6 lekë çmimin e gazit, me të cilin ngrohën serat dhe për investimet e tyre ua dhjetëfishon tavanin, ua çon deri në 5 milionë dollarë, kur dihet që shumica e tyre nuk kanë fuqi investuese kaq të mëdha për heqjen e TVSH-së për makineritë dhe për pajisjet, atëherë i godet brinjë më brinjë dhe i detyron të dalin atje. Si mund të duartrokasim ne dhe si mund ta kërkonim votën tonë kur ata, që janë edhe të interesuarit, e dhanë përgjigjen e tyre?! Çfarë mendoni ju se duhet të votojmë me ju dhe t'u kundërvihemi atyre?! Kjo është poshtërsi, me të gjithë kuptimin e plotë të fjalës. Produktet e tyre bujqësore hidhen në kanal; domatja dhe kastravecit shqiptar nuk vijnë dot nga Lushnja e nga Fieri në Tiranë, që janë me çmime qesharake, ndërkohë qytetarët e Tiranës detyrohen ta blejnë me 3-fishin e çmimit. Produkti vendas, edhe kilogrami i fundit, duhet të ishte në treg dhe të konsumohej nga shqiptarët, por ne konsumojmë produktet e importit. Kë do të bindni ju që bujqësia është në rregull?! Unë kam një pyetje për të gjithë dhe le të na japë qeveria një përgjigje të drejtpërdrejtë. Si ka mundësi që Maqedonia më e vogël se ne, Kosova më e vogël se ne, si popullsi, si sipërfaqe, si tokë e banuar, si klimë, me të gjitha oportunitetet pa fund, shtoj edhe mundësitë e tregtimit, qofshin tokësore dhe detare tonat më të mëdha, subvencionojnë shumë më tepër se Shqipëria? Meqenëse nuk e ktheni ju këtë përgjigje po jua kthej unë. Kjo është një qeverisje, që ata në periferi i lë të mbijetojnë; kush nuk mbijeton le të asgjësohet, nuk ka asnjë shqetësim, mjafton që ne të shkojmë përpara. Ju e shikoni që ky është një buxhet rutinor.

Paratë për koncesionet nuk lëvizin dhe dëgjojmë Kryeministrin, i cili thotë se qytetarët nuk do të paguajnë gjë, por do të paguajnë me buxhetin e shtetit. Çfarë buxheti ka ky? Buxhetin e tij, i merr nga shtëpia dhe mbush arkën e shtetit?! Kush e mbush buxhetin e shtetit?! Shqiptarët e mbushin. Pse ndodh kjo?! Sepse është konsideruar që kjo është kuleta e qeverisë dhe paratë i shpenzojnë si të duan ata; mijëra hallehinj në bujqësi nuk ekzistojnë, ndërsa klientët e zakonshëm të qeverisë i marrin rregullisht paratë e koncesioneve. E dëgjuat Kryeministrin kur tha: "Ne paguajmë 42 milionë dollarë për të mbështetur kompensimin e energjisë". Por çfarë janë 42 milionë dollarë për këtë qeveri?! Janë vetëm 2 kilometra rrugë. Është qesharake. Në këtë pikëpamje, sot Shqipëria futet në një qorrsokak akoma më të madh, sepse nga një buxhet, i cili duhet ta konsolidonte biznesin vendas, të konsolidonte një lloj qetësie sociale, e cila vjen nga një biznes që është duke u zhvilluar dhe nga produktiviteti i tij krijon mundësi punësimi dhe krijon motive më të mëdha, në një buxhet, i cili i përzë shqiptarët dhe ua humbet motivet. Ju e dini që shumë nga ata fermerë kanë financuar edhe nga kursimet e veta jo nga qeveria, për të ndërtuar serat apo gjërat e tjera, të cilat kanë të bëjnë me bujqësinë, por, megjithatë, përsëri janë në prag falimentimi.

Të kthehem te shëndetësia. Telegrafikisht po ju them se ky buxhet, meqenëse ndodhën ngjarje, që vazhdimisht thuhet se ndodhin 1 herë në 100 vjet, ishte një buxhet turpërisht rutinor, me një rritje të përhershme mesatare, ku rritja e rrogave të mjekëve, për turpin e të gjithëve, ishte 6%, që realisht, duke bërë zbritjet përkatëse, nuk është as 4%. Dëgjuam që ishte arritje historike, që do të rriten rrogat e ushtarakëve, kur të gjithë prisnim rrogat e mjekëve. Kemi dëgjuar brohorima dhe falënderime për punën e mirë, ngritëm lart emrin e mjekut dhe dëngla të kësaj natyre, por ku është shpërblimi për mundin e djersën e tyre?! Ata u përballën me një eveniment të jashtëzakonshëm, por edhe qeveria duhet të sillej në mënyrë të jashtëzakonshme. Ky është buxheti pas ngjarjeve të mëdha dhe pas bllokimeve të paimagjinueshme më parë, por ku është mirë shëndetësia?! Merreni dhe shikoni ritmin e investimeve, atë rutinorin, normalin! Të gjithë do të mendonin se kryefjala e këtij buxheti do të ishte shëndetësia, sepse ndodhën ngjarje të mëdha. Post pandemia vazhdon të ketë mijëra e mijëra njerëz, të cilët po vuajnë në të gjitha llojet e formave, (kjo është për atë që do ta shohë realitetin dhe për atë që ka vendosur t'i dojë shqiptarët), por çfarë ndodhi?! Siç e shikoni më së miri, kemi një buxhet nga

më të zakonshmit. Mjekët u ngopën me lavdërime, por me asnjë masë konkrete. Të gjitha objektet, edhe ato të filluarat, janë të lëna në mes. Pra, është fare e qartë që një buxhet i tillë, i cili vazhdon të jetë një thes i madh, që klientët e qeverisë dhe qeveria vetë fillon ta ndajë, është një buxhet armiqësor për shqiptarët dhe nuk mundet kurrën e kurrës të votohet pro. Faleminderit!